



BASHKIA  
TIRANË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA E TIRANËS  
AGJENCIA E PARQEVË DHE REKREACIONIT

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë më, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, 2022

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data]: 03/11/2022

Drejtuar: **“AIR” Sh.p.k** me adresë: Tirane, rruga "Siri i Kodra" Nr. 8340. Nr. Pasurie 5/450, Njesia Administrative Nr.8.

Procedura e prokurimit **Procedure e hapur e thjeshtuar**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-45953-10-14-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Dizinsektim i parqeve dhe objekteve ne parqe**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr.146 datë 24 Tetor 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **“LOERMA”shpk**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L0292804T**

*Numri i NIPT-t*

Vlera **2 492 736** (dy milion e katerqind e nentedhjete e dy mije e shtateqind e tridhjte e gjashte) **lekë pa Tvsh**

2. **“XHOVAN GJINI” PF**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L71806046M**

*Numri i NIPT-t*

Vlera **3 164 000** (tre milion e njeqind e gjashtedhete e kater mije) **lekë pa Tvsh**

3. **“AIR” Sh.p.k**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L51712008C**

*Numri i NIPT-t*

Vlera **3 168 000** (tre milion e njeqind e gjashtedhete e tete mije) **lekë pa Tvsh**

4. **“SILVER” Sh.p.k**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**K88010301S**

*Numri i NIPT-t*

Vlera **3 288 000** (tre milion e dyqind e tetedhete e tete mije) **lekë pa Tvsh**

**Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. **“LOERMA”shpk**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L0292804T**

*Numri i NIPT-t*

*arsyet e mëposhtme:*

Operatori ekonomik nuk plotëson kriteret si më poshte;

- Nuk I plotëson kriteret e veçanta të përcaktuara në DST.
- OE “LOERMA” Sh.p.k nuk plotëson pikën 2.3.7 të DST, pasi nuk ka paraqitur (a)certifikatën e kontrollit teknik të mjetit të markës ford me targë AA531EE, (b)katalogun e pompës mjegulluese (c)skedën teknike të pompës mjegulluese, (ç)certifikatën e konformitetit.
- OE “LOERMA” Sh.p.k nuk plotëson pikën 2.3.8 të DST, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion që provon disponimin e 1 dozatori për granual dhe 1 dozatori

për lëng. Gjithashtu OE “LOERMA” Sh.p.k nuk ka paraqitur skedat teknike të përkthyer dhe të noterizuara për pompat dhe pajisjet që disponon.

- OE “LOERMA” Sh.p.k nuk plotëson pikën 2.3.9 të DST, pasi nuk ka paraqitur të gjitha produktet që do të përdoren sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në shtojcën 5, konkretisht nuk ka paraqitur **(a)** produktet të llojit larvicide biologjike (*pika 1 e specifikimeve teknike*), **(b)** produkti gatshëm me veprim fiziko-mekanik në trajt likuide me bazë vaj vegjetal për kontrollin e larvave të mushkonjave (*pika 2 e specifikimeve teknike*), **(c)** Preparat për largimin e zvarranikëve me përbërje vaj kamfure (*pika 5 e specifikimeve teknike*), **(ç)** Preparat biologjik me përmbajtje natyrale për eliminimin e gazrave dhe aromave të këqija të pushtave dhe ujave të ndotura (*pika 6 e specifikimeve teknike*), **(d)** Preparat biologjik me përmbajtje natyrale që bën të mundur, degradimin, stabilizimin, dezinfektimin e elementëve organik të ngrurtë dhe të lëngshëm (*pika 7 e specifikimeve teknike*).
- OE “LOERMA” Sh.p.k nuk plotëson pikën 2.3.10 të DST, pasi nuk ka paraqitur etiketat në gjuhën shqip të produkteve që do të përdoren për kryerjen e shërbimit, ku të jenë specifikuar të gjitha karakteristikat e përcaktuara në dokumentin e regjistrimit dhe etiketën e aprovuar, si emir I lëndës aktive, doza e përdorimit, data e prodhimit dhe data e skadencës.

5. **“XHOVAN GJINI” PF**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L71806046M**

*Numri i NIPT-t*

*arsyet e mëposhtme:*

Operatori ekonomik nuk plotëson kriteret si më poshte;

- Nuk I plotëson kriteret e veçanta të përcaktuara në DST.
1. OE XHOVAN GJINI P.F nuk plotëson pikën 1.b të kriterëve të kualifikimit të përcaktuar në DST, pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3 të DST-së.
  2. OE XHOVAN GJINI P.F nuk plotëson pikën 2.2.1 të DST-së pasi nuk ka paraqitur vërtetimin e xhiros vjetore për periudhën 2019, 2020, 2021.
  3. OE XHOVAN GJINI P.F nuk plotëson pikën 2.3.1 të DST-së pasi nuk ka paraqitur dëshmi për shërbime të gjashme të kryera gjatë 3 viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së spërlllogaritur të kontratës.

4. OE XHOVAN GJINI P.F nuk plotëson pikën 2.3.2 të DST-së pas nuk ka paraqitur licensat profesionale me kod II.8/a, II.8/b dhe II.8/c si dhe nuk ka paraqitur Aktin e miratimit Higjeno-Sanitar për mgazinën /vend ruajtjen e preparateve DDD dhe për 1 automjet te transporti të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor.
5. OE XHOVAN GJINI P.F nuk plotëson pikën 2.3.3 të DST-së pasi nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 9) drejtuesin teknik të subjektit.
6. OE XHOVAN GJINI P.F nuk plotëson pikën 2.3.4 të DST-së pasi nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 9) numrin e punonjësve prej 7 perosnash të ndarë sipas certifikimeve që kërkohen.
7. OE XHOVAN GJINI P.F nuk plotëson pikën 2.3.5 të DST-së pasi nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 9) numrin e nevojshëm të punonjësve të kërkuar.
8. OE XHOVAN GJINI P.F nuk plotëson pikën 2.3.6 të DST-së pasi nuk ka paraqitur certifikatat ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 14001:2018 dhe PASS 99:2012
9. OE XHOVAN GJINI P.F nuk plotëson pikën 2.3.7 të DST-së pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin që provon disponimin e një automjeti pick-up dhe disponimin e një pompe mjegulluese me makineri cold fogging.
10. OE XHOVAN GJINI P.F nuk plotëson pikën 2.3.8 të DST-së pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin që provon disponimin e pompave, dozatorëve dhe atomizatorit të kërkuara për përmbushjen e shërbimit, si dhe skedat teknike të tyre të përkthyer dhe të noterizuara.
11. OE XHOVAN GJINI P.F nuk plotëson pikën 2.3.9 të DST-së pasi nuk ka paraqitur certifikatat e orgjinës për produktet e paraqitura si dhe skedat e sigurisë (MSSD) për produktet Aquabac 200G, Aquabac DF 300, Aquabac XT janë paraqitur në gjuhë të papërkthyer nga gjuha e huaj.
12. OE XHOVAN GJINI P.F nuk plotëson pikën 2.3.10 të DST-së pasi nuk ka paraqitur etiketat për produktet Murin forte pasta, Cytrol 10-4 ULV, Solfac Combi Zanzare e altri inseti si dhe etiketat e paraqitura për produktet Aquabac 200G, Aquabac DF 300, Aquabac XT janë paraqitur të papërkthyer nga gjuha e huaj.
13. OE XHOVAN GJINI P.F nuk ka paraqitur kopje të certificates së fiskalizimit dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e çertifikuar përzgjidhjen e software-it për tatim paguesin sikurse është për caktuar në pikën 2.3.11 dhe 2.3.12 të DST.

3. **“SILVER” Sh.p.k**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**K88010301S**

*Numri i NIPT-t*

*arsyet e mëposhtme:*

Operatori ekonomik nuk plotëson kriteret si më poshte;

- Nuk I plotëson kriteret e përgjithshme sipas DST.
- Nuk I plotëson kriteret e veçanta të përcaktuara në DST.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument të kërkuar në DST përveç ofertës ekonomike

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“AIR” Sh.p.k** me adresë: Tirane, rruga "Siri i Kodra" Nr. 8340. Nr. Pasurie 5/450, Njesia Administrative Nr.8, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **3 168 000** (tre milion e njëqind e gjashtedhjetë e tetë mijë) **lekë pa Tvsh** / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Erinda FINO**